

rishpall:
KONKURS PUBLIK
Për plotësimin e vendit të lirë të punës

UDHËHEQËS I MEDIEVE ONLINE NË RTK

- 1 POZITË (NR. 2602)

Detyrat

- Planifikon, organizon dhe mbikëqyr tërë procesin e punës së Medieve Online të RTK-së – Portali, Facebook, Youtube, Twitter;
- Bart përgjegjësi editoriale për të gjitha publikimet si tekstuale ashtu edhe vizuale në mediet online;
- Koordinon procesin e punës me kryeredaktorët e Portalit, RTK 1,3-TV; RTK 2-TV dhe RTK Radios;
- Koordinon përzgjedhjen e materialeve për publikim në mediet online të RTK-së;
- Harton strategji për të sjellë vazhdimisht ndryshime të reja e cilësore;
- Përkujdeset për freskimin e rregullt të të gjitha materialeve të publikuara;
- Bashkëpunon te përgatitja e planeve për arsimim, aftësim profesional dhe trajnim të stafit;
- Mban takimet për biseda të rregullta vjetore me bashkëpunëtorët e vet;
- Përgatit kushtet organizative për aftësim;
- Përcjell njohuritë profesionale te bashkëpunëtorët;
- Është bashkëpërgjegjës për zhvillim dhe avancim profesional për bashkëpunëtorët.

Kushtet

- Kualifikimi superior;
- Së paku dy (2) vite përvojë në punë të ngjashme;
- Njohje shumë e mirë e gjuhës amtare në të shkruar dhe në të folur;
- Njohje e gjuhës angleze në të folur dhe në të shkruar;
- Njohje e shkëlqyer e punës me kompjuter;
- Gatishmëri për të punuar me ndërrime dhe me orar të zgjatur;
- Njohje dhe interesim lidhur me programin e përgjithshëm të RTK-së;
- Përkushtimi ndaj shërbimit publik informativ;
- Ndershmëria, kreativiteti dhe aftësia për të punuar me vetiniciativë.

Për këtë vend të punës është e paraparë kontrata e punës me kohë të caktuar, me periudhë provuese prej tre muajve.

Kandidatët e paraqitur për këtë pozitë duhet:

- të jenë shtetas të Republikës të Kosovës - regjistruar sipas dispozitave ligjore në fuqi;
- të mos kenë angazhime, biznese, etj. të cilat mund të konsiderohen si konflikt interesi.

Kandidatët duhet të dorëzojnë:

- një CV;
- dëshmitë e kualifikimit të noterizuara;
- një kopje të letërnjoftimit ose pasaportës;
- një letër motivuese;
- dy referenca;
- dëshmi të përvojës;
- dëshmi nga Gjykata kompetente që nuk kanë qenë të dënuar me vendim të plotfuqishëm për vepër penale të dënueshme më shumë se gjashtë muaj (të lëshuar gjatë muajit të fundit para aplikimit),
- aplikacionin i cili duhet të shkarkohet nga uebfaqja e RTK-së: <https://www.rtklive.com/sq/docs/2022-02-05/231.doc>

Dokumentacioni i kompletuar duhet të dorëzohet i skanuar, në mënyrë elektronike, përmes e-mail adresës: konkurs@rtklive.com, prej 11.01.2023 deri më 25.01.2023 në orën 16:00.

Vetëm aplikacionet dhe dokumentet e dorëzuara përmes postës elektronike do të pranohen.

Aplikacioni dhe dokumentacioni i pakompletuar nuk do të merret në konsiderim.